# DËSHMI ARKIVI

**A-469864**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Top Channel/ UET feston 20-vjetorin, dekada e tretë nis me një kampus të ri - Top Channel |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/video/top-channel-uet-feston-20-vjetorin-dekada-e-trete-nis-me-nje-kampus-te-ri/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 18:10:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| KOHA E PORTALIT | nuk jepet<br>*Ky portal nuk e deklaron datën dhe nuk e shkruan as të dukshme. Mbetet vetëm ora jonë e kapjes.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `83ef177ac8be9459ff706cc118451d4330713b730ccd3276edd4be36ab4668d4` |
| TEKSTI | `12231cc4441b9a9c054c4d79ac6e7cd63a899fbfd16d2a08a596890b96a523c1` |
| PAMJA | `3ec5e0ea06163110dc9aab1cd5b9d85d5dbe91d496422404a0210b6547dd6134` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e2e1a67de766f1bf63971f2ef7377673670f49bb9d9be4d11e9601c2e079eb09` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e2e1a67de766f1bf63971f2ef7377673670f49bb9d9be4d11e9601c2e079eb09`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

## VIDEO

# Top Channel/ UET feston 20-vjetorin, dekada e tretë nis me një kampus të ri

25/09/2026 20:09

Dy dekada aktivitet që kanë transformuar arsimin e lartë shqiptare. Universiteti Europian i Tiranës festoi 20-vjetorin e themelimit të tij në një mbrëmje festive në Pallatin e Brigadave, ku u bashkuan themelues, drejtues, akademikë, studentë, ish-studentë, partnerë dhe personalitete të jetës publike. I hapur në shtator të vitit 2006 nga ëndrra e gjashtë të rinjve, UET u kthye shpejt në një pol të rëndësishëm të dijes, cilësisë së lartë akademike, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit. Ndër vite, ai ka regjistruar mbi 30 mijë studentë, ka pranuar mbi 2500 pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm, ka ofruar me dhjetëra programe e profile, dhe ka qenë iniciator dhe nxitës i shumë proceseve që kanë ndryshuar arsimin jopublik në Shqipëri. "Vendimet strategjike që drejtuesit e UET kanë marrë përgjatë viteve e kanë zgjeruar dhe diversifikuar ofertën akademike në profesione e zanate që kërkohen sot si nga tregu vendas, ashtu edhe ai i huaj. Pyetja kryesore që qëndron përpara nesh tashmë është jo se si të rritemi përmes zgjerimit, por si të krijojmë një vlerë të dallueshme, unike dhe se si të ripërshtatemi në mënyrë dinamike, duke iu përgjigjur kontekstit krejt të ri shoqëror dhe teknologjik."
"Sot UET bashkëpunon me më shumë se 150 universitete në Evropë dhe më gjerë, duke krijuar mundësi për mobilitet, kërkim, diploma të dyfishta dhe diploma të përbashkëta. Këtë vit akademik presim rreth 200 studentë ndërkombëtarë, që tregojnë besimin në cilësinë e programeve tona dhe në standardet akademike të certifikuara dhe nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë. Ky është UET që duam, një universitet shqiptar me orientim evropian dhe ndërkombëtar, që di t'u përgjigjet zhvillimeve të kohës."
Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Erjona Ismaili, si studente e diplomuar në UET, foli për impaktin që pati ky universitet në transformimin e arsimit të lartë privat. "Në gjithë përvojën time, UET-i më ka ndryshuar rrënjësisht edhe një tjetër




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.